



Pranuar / Dërguar Punëtor / Pradato Received / Delivered	01.11.2023	3 viti god year	
Organ / Bërsia Organ / Bërsia Org / Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6822/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1175/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1175/2023, të datës 19.09.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1175/2023, e datës 19.09.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 19.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr.1442/2023 të datës 08.09.2023, të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimin që ti njihen ditët e pushimit mjekësor nga data 01.09.2023 deri më 15.09.2023, me kompensim prej 70% të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*më tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministri e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit, me datë 03.10.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6144/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1442 të datës 08.09.2023 të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Kërkesën e datës 29.08.2023 për pushim mjekësor nga ankuesja e parashtruar tek organi i punësimit; Raportin specialistik të datës 28.08.2023 nga Shkresën zyrtare lidhur me konstatimin e mjekut të datës 13.04.2023 nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë; Raportin mjekësor të datës 13.04.2023 nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-Klinika Emergjente në Prishtinë; Raportin specialistik të datës 23.04.2023; Akt emërimit e ankueses me Nr.prot.66 të datës 04.02.2014; Vërtetimin me Nr.prot.15 të datës 24.04.2013 lidhur me marrëdhënien e punës së ankueses; Raportin e datës 18.09.2023 lidhur me ndërprerjen e përkohshme në punë; Raportin mjekësor të datës 30.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Shkresën lidhur me shfrytëzimin e pushimit të realizuar nga ana e ankueses si dhe listën e pagave të ankueses për muajt gusht, shtator dhe tetor të vitit 2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses [redacted] **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (me tej referuar MPB) dhe së e njëjta sipas Akt emërimit me Nr.Prot.66 të datës 04.02.2014, mbanë pozitën e punës *Koordinatorë për Standarde-Arkitekturë e Ndërtimtarisë*.

Ankuesja me datë 29.12.2022 kishte parashtruar kërkesë për pushim mjekësor si pasojë e lëndimit në punë të Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në kohëzgjatje prej 90 ditëve, duke mbështetur këtë kërkesë mbi bazën e dispozitave të nenit 12 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së me vendimin e kontestuar gjegjësisht Vendimin me Nr.1442/2023 të datës 08.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankueses të datës 29.08.2023 mbi arsyetimin së sipas raporteve mjekësore të prezantuar nga ankuesja, nuk është rekomanduar pushim mjekësor me i gjatë se 20 ditë, e qe do ta pamundësonte ardhjen në punë të se njëjtës.

Ankuesja kundër Vendimit Nr.1442/2023 të datës 08.09.2023, lidhur me refuzimin e ankesës për pushim mjekësor për shkak të lëndimit në punë, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për shfrytëzimin e pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin sipas nenit 12 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) ditë pune si mungesë nga puna konkretisht nga data 01.09.2023 deri më 15.09.2023, me kompensim prej 70% të pagës.

Në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i 'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, (ligj ky i aplikueshëm për periudhën kohore në rastin e ankueses), përkatësisht Nenit 18 paragrafi 5, sipas të cilit është përcaktuar se: "5. Kriteret

dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë” si dhe Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht: Nenit 12, paragrafit 4, 5, 6 dhe 7 sipas të cilit është përcaktuar se: “...4. Zyrtari publik ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagesës së tij. 5. Dëshmi nga organi kompetent mjekësor sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, nënkupton dëshminë e cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. 6. Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdoj pushimin pa pagesë. 7. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagesës nga paragrafi 6 i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës”.

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes, përkatësisht: raportin e mjekut nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë të datës 13.04.2023, sipas të cilit ishte konstatuar se ankuesja pas rrëzimit në lift duke hy në punë kishte pësuar dhimbje shpine e cila ishte përhapur në të dy krahët me intensitet mesatar. Tutje sipas shkresës zyrtare të lëshuar nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës-Qendra Emergjente (pa datë) sipas të cilit ankueses pas ekzaminimit mjekësor i është rekomanduar pushimi mjekësor për tri (3) ditësh. Ndaj të njëjtës po ashtu me datën 23.04.2023 Mjeku Specialist Ortoped V.B, përmes raportit specialistik të datës 23.04.2023, pas ekzaminimit mjekësor rekomandon pushim mjekësor edhe një (1) javë. Ndërsa, sipas raportit specialistik të datës 28.08.2023 të lëshuar nga ortoped-traumatolog nga [redacted] pas ekzaminimit mjekësor i është rekomanduar pushim mjekësor në periudhën prej tri (3) javësh, dhe së bazuar në këtë rekomandim mjeku familjar me raportin e datës 18.09.2023 ka aprovuar pushim mjekësor të ankueses për periudhë nga data 30.08.2023 deri me 15.09.2023(gjithsej 13 ditë pune)

Po ashtu nga shkresat e lëndës rrjedhë së sipas Raportit të evidencës së pushimeve ankuesja nga data e rrëzimit në punë 13.04.2024 e deri në datën e lëshimit të vendimit të kontestuar ka realizuar pushim mjekësor gjithsej prej 14 ditësh, dhe së e njëjta sipas listave të pagesës ka realizuar pagë të plotë për muajt gusht dhe shtator 2023, pra ditët e pushimit mjekësor i janë paguar me 100% të pagesës.

Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve Kolegji konstaton së vendimi i kontestuar është nxjerrë në pajtim me dispozitat materiale, sepse ankuesja përmes kërkesës me Nr.919 të datës 29.08.2023 të parashtruar të Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kërkuar që ti aprovohet pushimi mjekësor si pasojë e lëndimit në punë në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë me kompensim prej 70% të pagesës duke filluar nga data 29.08.2023 , mirëpo, ankuesja kishte ofruar dëshmi mjekësore me rekomandim nga mjeku specialist vetëm në kohëzgjatje prej tri javësh e jo për periudhën 90 ditësh, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit thekson faktin së ankuesja në rast të prolongimit të sëmundjes si pasojë e lëndimit në punë, të njëjtës i takon e drejta e realizimit të pushimit mjekësor me 70 % të pagesës për shkak të lëndimit në punë në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe me kusht që e njëjta posedon dëshmi mjekësore nga organi kompetent.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1175/2023

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së